



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
KRYETARI

Nr. \_\_\_\_\_ Regj.

Ballsh, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2020

Lënda: **Dërgohet për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, Formulari i Njoftimit të Fituesit**

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK – TIRANË (SPE)**

për ngarkim në sistemin e prokurimit elektronik të APP, në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**BASHKIA MALLAKASTËR**

Data 10.09.2020

Për: **Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë (BOE) “ERGI” shpk, me NIPT K02727229P & “2 T” shpk, me NIPT K01731001M & “SHKELQIMI 07” shpk, me NIPT K68121808W & “BE-IS” shpk, me NIPT K71412003A, përfaqësuar nga “2T” shpk, me adresë Rruga “Asim Vokshi”, Nd.14, H.4, Ap.5.**

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **“E hapur”**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-58017-05-13-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”, me fond limit 421,842,119 (katërqind e njëzetë e njëmilion e tetëqind e dyzetë e dymijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, me afat 24 (njëzetë e katër) muaj.**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.28, datë 18 maj 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “ERGI” shpk, me NIPT K02727229P & “2 T” shpk, me NIPT K01731001M & “SHKELQIMI 07” shpk, me NIPT K68121808W & “BE-IS” shpk, me NIPT K71412003A, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej 416,094,749 (katërqind e gjashtëmbëdhjetëmilion e nëntëdhjetë e katërmijë e shtatëqind e dyzetë e nëntë) lekë pa TVSH.**

2. **Operatori Ekonomik “K.M.K” shpk**, me NIPT L78223801E, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
3. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “PE-VLA-KU” shpk**, me NIPT K61716013M & **“L.T.E CONSSTRUCTION” shpk**, me NIPT L78006801F & **“BOSNJAKU. B” shpk**, me NIPT K72627402H, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **400,988,723** (katërqindmilion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetëmijë e shtatëqind e njëzetë e tre) **lekë pa TVSH.**

#### **Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

##### **1. Operatori Ekonomik “K.M.K” shpk, me NIPT L78223801E, për arsyet e mëposhtme:**

- Nuk plotëson asnjë prej kërkesave të kualifikimit, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e tyre. Ky operator nuk ka paraqitur as ofertë ekonomike.

##### **2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “PE-VLA-KU” shpk, me NIPT K61716013M & “L.T.E CONSSTRUCTION” shpk, me NIPT L78006801F & “BOSNJAKU. B” shpk, me NIPT K72627402H, për arsyet e mëposhtme:**

- Nga njëri prej anëtarëve të BOE, konkretisht “PE-VLA-KU” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.2.3. e kapacitetit ekonomik dhe financiar, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi referuar dokumentit të ngarkuar në sistem “Vërtetim Debie...” lëshuar nga FSHU (OSHEE GROUP) Tiranë, me nr.1149 prot, datë 27.04.2020, rezulton se është paguar detyrimi për muajin Mars 2020, ndërkohë që referuar datës së zhvillimit të kësaj procedure (15.06.2020), duhej të ishte paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për muajin Prill 2020, muaj i cili është maturuar në datën 31 Maj 2020. Në nenin 26, pika 7, shkronja “c”, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet se: *“...Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik ..”*. Gjithashtu, në nenin 9 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 9.1, i kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet se: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”*.

Sa më sipër, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit 15.06.2020 dhe përcaktimeve të bëra në vendimin e sipërcituar të ERE, rezulton se detyrimet e energjisë elektrike për muajin Prill 2020 janë maturuar dhe anëtari i BOE “PE-VLA-KU” shpk nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimit të këtij muaji, gjë e cila përbën shkak për skualifikim sipas nenit 26, pika 7, shkronja “c”, të VKM nr.914, datë 29.12.2014.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSSTRUCTION” shpk & “BOSNJAKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga dy prej anëtarëve të BOE, konkretisht “L.T.E CONSTRUCTION” shpk dhe “BOSHNJAKU. B” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.1. e kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme, pasi:

“L.T.E CONSTRUCTION” shpk, ka paraqitur si punë të ngjashme 3 (tre) kontrata të lidhura me UKT Tiranë si vijon: 1. Kontrata nr.28562/6 prot, datë 18.02.2019, me objekt “Instalimi i sistemit ujëmatës në burimet e ujësjellësit të Tiranës”, me vlerë 24,592,244 lekë pa TVSH, kontratë në të cilën “L.T.E CONSTRUCTION” shpk merr pjesë si bashkim operatorësh në raportin 87,66 %, me vlerë takuese 21,557,561 lekë pa TVSH; 2. Kontrata nr.9520/6 prot, datë 15.08.2019, me objekt “Rikonstruksion rrjet ujësjellësi të rrjetit të vjetër në rrugët që lidhen me Rrugën e Kavajës, Mihal Duri, Kont Urani”, me vlerë 22,277,966 lekë pa TVSH; 3. Kontrata nr.9521/10 prot, datë 15.08.2019, me objekt “Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën që kufizohet nga rrugët Vangjel Noti, Qemal Dracini, Bruzi dhe shinat e trenit”, me vlerë 11,904,218 lekë pa TVSH. Të treja kontratat e mësipërme të marra sëbashku, kapin vlerën e përgjithshme prej 55,739,745 lekë pa TVSH, ndërkohë që referuar pjesëmarrjes së “L.T.E CONSTRUCTION” shpk në BOE me 33 %, duhej që vlera e këtyre kontratave të ishte në shumën 69,603,949 lekë pa TVSH.

“BOSHNJAKU. B” shpk, si punë të ngjashme ka paraqitur kontratat si vijon: 1. Investitor për kontratën me objekt “1 kat bodrum + 2 kate lokale + 8 + 1 kate banesë”; 2. Kontrata nr.5355 prot, datë 06.09.2016, me objekt “Rikualifikim i hapësirave publike dhe rrugës hyrëse pranë Memorialit të rilandasve Gjirokastër”, lidhur me Bashkinë Gjirokastër; 3. Kontrata nr.224 prot, datë 18.05.2017, me objekt “Rikonstruksion sistemim asfaltim rruga K/Korçë Gorice Gollomboc”, lidhur me Bashkinë Pustec; 4. Kontrata nr.2076/2 prot, datë 30.06.2017, me objekt “Rikonstruksion i rrugës Xhami-Golem”, lidhur me Bashkinë Kavajë; 5. Kontrata nr.1802 regj, datë 06.10.2016, me objekt “Ndërtim shkollë 9 vjeçare 2 Kt + kalçeto dhe kënd sportive, në fshatin Panahor-Mallakastër”, lidhur me Bashkinë Mallakastër. Të pesta kontratat e mësipërme nuk konsiderohen kontrata të ngjashme, pasi natyra e zërave të punimeve të realizuara në këto kontrata, nuk është e profilit ujësjellës kanalizime.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSCTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga dy prej anëtarëve të BOE, konkretisht “L.T.E CONSTRUCTION” shpk dhe “BOSHNJAKU. B” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.2. e kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, lidhur me numrin e punonjësve të punësuar për periudhën nëntor 2019 – prill 2020, pasi:

“L.T.E CONSTRUCTION” shpk, referuar vërtetimit për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe listëpagesave për periudhën nëntor 2019 – prill 2020 ka të punësuar mesatarisht 48 punonjës, ndërkohë që referuar pjesëmarrjes së “L.T.E CONSTRUCTION” shpk në BOE me 33 %, duhej që të kishte të punësuar 72 punonjës.

“BOSHNJAKU. B” shpk, referuar vërtetimit për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe listëpagesave për periudhën nëntor 2019 – prill 2020 ka të punësuar

mesatarisht 56 punonjës, ndërkohë që referuar pjesëmarrjes së “L.T.E CONSTRUCTION” shpk në BOE me 33 %, duhej që të kishte të punësuar 72 punonjës.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNAJKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNAJKU. B” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.2. nënpika 2. e kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi të marrë së bashku, të tre anëtarët e bashkimit kanë në total 8 (tetë) punonjës të pajisur me çertifikatë për dhënien e ndihmës së parë, ndërkohë që referuar kërkesës së përcaktuar duhet të plotësojnë numrin prej 10 (dhjetë) punonjës të pajisur me çertifikatë për dhënien e ndihmës së parë.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNAJKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga njëri prej anëtarëve të BOE, konkretisht “BOSHNAJKU. B” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.2. nënpika 3. e kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi referuar listëpagesave të paraqitura rezulton se mjekja A.Shehaj nuk figuron e siguruar në listëpagesën e muajit Shkurt 2020, gjë e cila nuk plotëson kërkesën për sigurimin e saj së paku tre muajt e fundit (Shkurt 2020 – Prill 2020).

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNAJKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNAJKU. B” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.2. nënpika 4. e kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nga 5 (pesë) punonjës hidroizolues të kërkuar, të tre anëtarët e bashkimit, të marrë së bashku nuk kanë dokumentacion të plotë për asnjë nga punonjësit e paraqitur si hidroizolues, pasi:

“L.T.E CONSTRUCTION” shpk, ka prezantuar 5 (pesë) punonjës si hidroizolues: A.Qalliu, T.Demaj, Sh.Morina, F.Hysa dhe B.Neza, për të cilët është paraqitur vetëm kontrata dhe dëshmia e sigurimit teknik dhe nuk është paraqitur dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës). Gjithashtu B.Neza nuk figuron në listëpagesën e muajit Prill 2020.

“BOSHNAJKU. B” shpk, ka prezantuar 1 (një) punonjës si hidroizolues: I.Boho, për të cilin është paraqitur vetëm kontrata dhe dëshmia e sigurimit teknik dhe nuk është paraqitur dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës).

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNAJKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSSTRUCTION” shpk & “BOSNJAKU. B” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.2. nënpika 4. e kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nga 4 (katër) punonjës hidraulik të kërkuar, të tre anëtarët e bashkimit, të marrë së bashku kanë dokumentacion të plotë vetëm për 2 (dy) nga punonjësit e paraqitur si hidraulik, pasi:

“PE-VLA-KU” shpk, ka prezantuar 1 (një) punonjës si hidraulik: L.Pjetërgjokaj, për të cilin është paraqitur vetëm kontrata dhe dëshmia e sigurimit teknik dhe nuk është paraqitur dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës).

“L.T.E CONSTRUCTION” shpk, nga 3 (tre) punonjës të prezantuar si hidraulik, për 2 (dy) është paraqitur dokumentacion i plotë, ndërsa për 1 (një) konkretisht A.Malaj është paraqitur vetëm kontrata dhe dëshmia e sigurimit teknik dhe nuk është paraqitur dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës).

“BOSNJAKU. B” shpk, ka prezantuar 3 (tre) punonjës si hidraulik: F.Shkrela, L.Dulla dhe V.Dulla, për të cilët është paraqitur vetëm kontrata dhe dëshmia e sigurimit teknik dhe nuk është paraqitur dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës).

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSNJAKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSSTRUCTION” shpk & “BOSNJAKU. B” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.2. nënpika 4. e kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nga 2 (dy) punonjës mekanik të kërkuar, të tre anëtarët e bashkimit, të marrë së bashku nuk kanë dokumentacion të plotë për asnjë nga punonjësit e paraqitur si mekanik, pasi:

“PE-VLA-KU” shpk, ka prezantuar 1 (një) punonjës si mekanik: A.Islamaj, për të cilin është paraqitur vetëm kontrata dhe dëshmia e sigurimit teknik dhe nuk është paraqitur dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës).

“L.T.E CONSTRUCTION” shpk, ka prezantuar 1 (një) punonjës si mekanik: I.Goxha, për të cilin është paraqitur vetëm kontrata dhe dëshmia e sigurimit teknik dhe nuk është paraqitur dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës).

“BOSNJAKU. B” shpk, ka prezantuar 1 (një) punonjës si mekanik: A.Osmënaj, i cili nuk figuron në listëpagesën e muajit Prill 2020.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSNJAKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSSTRUCTION” shpk & “BOSNJAKU. B” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.2. nënpika 4. e kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nga 7 (shtatë) punonjës sladator të

kërkuar, të tre anëtarët e bashkimit, të marrë së bashku kanë dokumentacion të plotë vetëm për 4 (katër) nga punonjësit e paraqitur si saldator, pasi:

“PE-VLA-KU” shpk, ka prezantuar 1 (një) punonjës si saldator: D.Avdullari, për të cilin është paraqitur vetëm kontrata dhe dëshmia e sigurimit teknik dhe nuk është paraqitur dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës). Gjithashtu, ky punonjës nuk figuron në listëpagesën e muajit Prill 2020.

“L.T.E CONSTRUCTION” shpk, nga 7 (shtatë) punonjës të prezantuar si saldator, për 3 (tre) është paraqitur dokumentacion i plotë, ndërsa për 4 (katër) konkretisht B.Dosti, F.Hysa, T.Demaj dhe B.Neza është paraqitur vetëm kontrata dhe dëshmia e sigurimit teknik dhe nuk është paraqitur dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës). Gjithashtu, B.Neza nuk figuron në listëpagesën e muajit Prill 2020.

“BOSHNJAKU. B” shpk, nga 2 (dy) punonjës të prezantuar si saldator, për 1 (një) është paraqitur dokumentacion i plotë, ndërsa për 1 (një) konkretisht O.Dulla është paraqitur vetëm kontrata dhe dëshmia e sigurimit teknik dhe nuk është paraqitur dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës).

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.2. nënpika 4. e kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nga 10 (dhjetë) manovratorë mjetesh të rënda të kërkuar, të tre anëtarët e bashkimit, të marrë së bashku kanë dokumentacion të plotë vetëm për 9 (nëntë) nga punonjësit e paraqitur si manovratorë, pasi:

“PE-VLA-KU” shpk, nga 4 (katër) punonjës të prezantuar si manovratorë, për 1 (një) është paraqitur dokumentacion i plotë, ndërsa për 3 (tre) konkretisht E.Killogjri, I.Selimaj dhe R.Berberi nuk është paraqitur dëshmia e aftësisë profesionale për përdoruesit e mjeteve të rënda (leja e manovrimit).

“L.T.E CONSTRUCTION” shpk, ka paraqitur dokumentacion të plotë për 4 (katër) punonjës të prezantuar si manovratorë.

“BOSHNJAKU. B” shpk, ka paraqitur dokumentacion të plotë për 4 (katër) punonjës të prezantuar si manovratorë.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.2. nënpika 4. e kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nga 3 (tre) automakinistë të kërkuar, kanë dokumentacion të plotë vetëm për 2 (dy) nga punonjësit e paraqitur si automakinistë, pasi:

“PE-VLA-KU” shpk, dhe “BOSHNJAKU. B” shpk, nuk kanë prezantuar asnjë punonjës si automakinistë.

“L.T.E CONSTRUCTION” shpk, nga 4 (katër) punonjës të prezantuar si automakinistë, për 2 (dy) është paraqitur dokumentacioni i plotë, ndërsa për 2 (dy) konkretisht G.Sinaj dhe L.Avdiu rezulton se këta punonjës nuk figurojnë të siguar në listëpagesën e muajit Prill 2020.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.5. të kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk është paraqitur kontratë për depozitim të mbetjeve/inerteve me institucion shtetëror/ privat (i licencuar).

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.7. të kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi:

Në total nga 2 (dy) autobitumatriçe të kërkuara, është paraqitur dokumentacioni i rregullt vetëm për autobitumatriçen me targë AA680LP, kontraktuar me të tretë nga anëtari i BOE “PE-VLA-KU” shpk. Ndërsa autobitumatriçja me targë AA830LT, kontraktuar me të tretë nga anëtari i BOE “L.T.E CONSTRUCTION” shpk, nuk ka dokumentacion të rregullt sipas kërkesave të përcaktuara lidhur me mjetet që shënohen në regjistri publikë, pasi çertifikata e kontrollit teknik (SGS) ka humbur afatin e vlefshmërisë në datën 02.05.2020, si dhe policia e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni) ka humbur afatin e vlefshmërisë në datën 06.05.2020.

Nuk plotësohet kërkesa për të paktën një *Fabrikë asfalti e pajisur me leje mjedisore, me distancë jo më shumë se 30 km nga objekti që prokurohet*, pasi referuar dokumentacionit shoqëruar të kontratës noteriale të furnizimit nr.1310 rep, nr.700 kol, datë 26.04.2019, lidhur ndërmjet anëtarit të BOE “BOSHNJAKU. B” shpk dhe “A.A.C” shpk, rezulton se fabrika e asfaltit është në një distancë më të madhe se 30 km.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.9. të kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk është paraqitur plan organizimi në përputhje me afatin e realizimit të punimeve (grafiku).

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar mbas pikës 2.3.9. të kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, kërkesë e cila referon në zbatimin rigoroz të përcaktimeve të bëra në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, lidhur me dorëzimin e ofertave në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë. Konkretisht, referuar përcaktimeve të bëra në pikën 1 dhe 2, të nenit 74, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, citohet se:

*“1. ... Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.*

*“2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. ...”*

Referuar dokumentacionit të paraqitur, rezulton se është paraqitur Deklaratë Noteriale Nr.repertori: 3659, Nr.koleksioni: 2428, datë 13.06.2020 “Marrëveshje për bashkimin e përkohshëm të shoqërive”, në të cilën është përcaktuar pjesëmarrja e anëtarëve në bashkim në raportet: “PE-VLA-KU” shpk dhe “PE-VLA-KU” dega në Kosovë 34 %, “L.T.E CONSSTRUCTION” shpk 33 % dhe “BOSHNJAKU. B” shpk 33 %, por në asnjë rast nuk janë përcaktuar elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë (BOE) “ERGI” shpk**, me NIPT K02727229P & **“2 T” shpk**, me NIPT K01731001M & **“SHKELQIMI 07” shpk**, me NIPT K68121808W & **“BE-IS” shpk**, me NIPT K71412003A, përfaqësuar nga “2T” shpk, me adresë Rruga “Asim Vokshi”, Nd.14, H.4, Ap.5, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **416,094,749** (katërqind e gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e katërmijë e shtatëqind e dyzetë e nëntë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër lagjia “18 Prilli”, Ballsh, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.



Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 01.07.2020

Ankesa: PO

- Për këtë procedurë ka paraqitur ankesë “ILIRIA 2020” shpk, regjistruar në protokollin hyrës të AK Bashkia Mallakastër nr.1014/3 regj, datë 21.05.2020.  
Me shkresën përcjellëse nr.1014/6 regj, datë 22.05.2020 “Dërgim akti “Shqyrtim ankese”...”, palës ankimuese i është komunikuar akti nr.1014/5 regj, datë 22.05.2020 i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës mbi mos pranimin e ankesës.
- Për këtë procedurë ka paraqitur ankesë (lidhur me vlerësimin e ofertave) BOE “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk, regjistruar në protokollin hyrës të AK Bashkia Mallakastër nr.1493 regj, datë 07.07.2020.  
Me shkresën përcjellëse nr.1493/2 regj, datë 10.07.2020 “Dërgim akti “Shqyrtim ankese”...”, palës ankimuese i është komunikuar akti nr.1493/1 regj, datë 10.07.2020 i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës mbi mos pranimin e ankesës.  
Procedura është mbajtur e pezulluar pasi BOE “PE-VLA-KU” shpk & “L.T.E CONSSTRUCTION” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk, ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP). KPP me Vendimin Nr.343/2020, Datë 28.08.2020, ka vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Pe-Vla-Ku” sh.p.k & “Boshnjaku” sh.p.k & “L.T.E Construction” sh.p.k dhe lejimin e Autoritetit Kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Qerim Ismailaj**